



POLICY BRIEF

EVROPIAN

BASHKË-KRIJIM PËR KËRKIM E INOVACION TË PËRGJEGJSHËM: PËRVOJA NGA BALLKANI PERËNDIMOR



Proceset e bashkë-krijimit që u zhvilluan në gjysmën e parë të zbatimit të projektit WBC-RRI.net e kanë pasuruar këtë konsorcium me përvoja të reja, njohuri dhe mësim, të cilat i hapën rrugë disa rekomandimeve për aktorët e heliksit të katërfishtë në rajon, drejtuar qeverisjes, kërkimit shkencor dhe edukimit, sektorit privat dhe shoqërisë civile.

31 Gusht 2022

HYRJE

Qasja e Kërkimit dhe Inovacionit të Përgjegjshëm (RRI) synon të inkurajojë aktorët e shoqërisë që të punojnë së bashku gjatë gjithë procesit të kërkimit dhe inovacionit (R&I), për të harmonizuar më mirë R&I dhe rezultatet e tij me vlerat, nevojat dhe pritshmëritë e shoqërisë. Përvoja e mbledhur në disa projekte dedikuar RRI¹ tregon se strategjitë dhe praktikat e bazuara në RRI mund të shtrijnë kërkimin dhe inovacionin drejt të gjithë aktorëve relevantë dhe të përmirësojnë bashkëpunimin midis shkencës dhe shoqërisë, duke nxitur rekrutimin e talenteve të reja dhe duke bashkuar ekselencën shkencore me ndërgjegjësim dhe përgjegjësi të rritur sociale.

Territoret shfaqin avantazhe të qarta për të trajtuar kompleksitetin e sfidave që vijnë nga ndërveprimi midis shkencës dhe shoqërisë. Në fund të fundit, aktorët vendas kanë njohuri të thella për mjedisin fiziko-territorial dhe ekologjinë lokale, p.sh. për *status quo*-në e marrëdhënieve komplekse midis aktorëve kulturorë, socialë, ekonomikë dhe politikë, për dinamikën, historinë, pritshmëritë, kërkesat, si dhe shqetësimet specifike lokale. Territoret kanë mundësinë të shkojnë drejt krijimit të ekosistemeve të vetë-qendrueshme të R&I që karakterizohen nga një shkallë e lartë transparence, llogaridhënieje demokratike dhe përgjegjshmërie ndaj nevojave. Kjo mund të realizohet duke ndërmarrë aktivitete për të promovuar shtyllat e RRI (p.sh. barazinë gjinore, edukimin shkencor, aksesin e hapur/të dhënat e hapura, angazhimin publik dhe etikën), duke zbatuar njëkohësisht katër dimensionet e RRI (paraprirjen, refleksivitetin, inkluzivitetin dhe përgjigjen efektive).

¹si TeRRitoria, SeeRRI ose DigiTeRRI, etj. Për më shumë informacion, ju lutemi shikoni databazën CORDIS mbi projektet dhe rezultatet e BE-së [këtu](#).

Qasja e RRI kërkon bashkimin e aktorëve në partneritete reale, duke përfshirë qytetarët, organizatat e shoqërisë civile (OSHC), universitetet, institucionet kërkimore, institucionet arsimore formale dhe joformale (duke përfshirë shkollat fillore dhe të mesme), qeveritë dhe autoritetet publike (përfshirë administratat rajonale e vendore dhe institucionet e politikave shkencore), bizneset (duke përfshirë industrinë, sektorin e shërbimeve dhe sipërmarrësit socialë) dhe ndërmjetësuesit shkencorë. Zbatimi i metodave të reja të punës kërkimore brenda dhe ndërmjet organizatave, shoqëruar me një marrëdhënie më transparente me qeverisjen, do të nxiste qëndrueshmëri dhe gjithëpërfshirje më të madhe në nivel lokal, kombëtar, Evropian dhe global.

Konsorciumi WBC-RRI.NET synon të përpunojë dhe zbatojë një sistem kërkimi e inovacioni më të hapur, transparent dhe demokratik në pesë territoret e Ballkanit Perëndimor (BP) që marrin pjesë në projekt². Konsorciumi tashmë ka nisur dhe do të vazhdojë të zbatojë një sërë aktivitete rajonale që nxisin RRI, të cilat po shfaqin impaktin fillestar shoqëror, demokratik, mjedisor, ekonomik dhe shkencor. Ndër të tjera, projekti synon edhe të sjellë efekte transformuese të qëndrueshme për organizatat pjesëmarrëse, të cilat do shtrihen përtej kohëzgjatjes së vetë projektit. Të tilla janë format e reja të vendimmarrjes, zhvillimi i planeve të biznesit ose marrëveshjeve të bashkëpunimit, dhe, më kryesorja, ndryshime të mirëfillta institucionale në organizata, territoret e tyre dhe më gjerë.

DËSHMI DHE ANALIZA

Mësimet e Përvetësuara

WBC-RRI.NET zhvilloi një proces hartëzimi dhe bashkë-krijimi në nivel rajonal dhe kombëtar gjatë gjysmës së parë të projektit. Ky hartëzimi i thelluar, me pjesëmarrje sistematike, lejoi angazhimin e identifikimin e aktorëve kryesorë rajonalë, ndërsa bashkë-krijimi rajonal u fokusua në projektimin e iniciativave 'ankoruese' rajonale të RRI-së³ përmes një sërë *workshop*-esh rajonale me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse, të integruar (minimumi dy për çdo territor të BP). Aktivitetet e deritanishme të projektit dhe, veçanërisht, këto procese rajonale bashkë-krijimi u kanë ofruar partnerëve të WBC-RRI.NET një pasqyrë të vlefshme mësimesh të përvetësuara. Në vijim përshkruhen këto mësimet në detaj.

Përgjatë fazës së parë u bë një hartëzim me pjesëmarrje i thelluar dhe sistematik⁴, që mundësoi identifikimin e aktorëve kryesorë rajonalë për t'u angazhuar më tej. Ky ushtrim i suksesshëm identifikimi, kombinuar me krijimin e një rrjeti bashkëpunëtorësh potencialë, mund të sigurojë pjesëmarrjen e palëve të interesit në afatgjatë. Evidentimi dhe kapitalizimi mbi rastet më të mira rajonale që lidhen me RRI mund të tërheqë gjithashtu aktorë të rinj që përfaqësojnë të gjithë Heliksin e Katërfishtë (QH) (i përbërë nga përfaqësues nga akademia, industria/biznesi, sfera e politike dhe shoqëria). Së fundi, evidentimi i këndvështrimeve të reja dhe të ndryshme gjatë procedurave të bashkë-krijimit dhe kontekstualizimi i tyre në diskursin aktual – madje edhe përtej pjesëmarrësve – mund të hapë shtigje të reja për përthithjen e rezultateve të bashkë-krijimit në nivel rajonal.

² Pesë territoret e BP-së që marrin pjesë në projekt janë si më poshtë: 1) Ekosistemi lagunor Kune-Vain-Tale (Shqipëri); 2) Republika Srpska (Bosnje dhe Hercegovinë); 3) Mali i Zi; 4) Shkupi (Maqedonia e Veriut); 5) Provinca e Vojvodinës (Serbi).

³ Iniciativat 'ankoruese' të RRI-së janë ndërhyrje specifike që prekin çelësat specifikë të RRI-së, veçoritë territoriale dhe dimensionet shkencore në çdo territor të BP që është pjesë e projektit.

⁴ Më shumë detaje mbi metodologjinë e hartëzimit WBC-RRI.NET dhe rezultatet mund të gjenden në raportet e WBC-RRI.NET D1.1, D1.2 dhe D1.3.

Gjatë realizimit të aktiviteteve të bashkë-projektimit të WBC-RRI.NET, u vu re se *workshop*-et fizike dhe ato online mund të kenë efekte mjaft pozitive përse i përket përfshirjes dhe angazhimit të pjesëmarrësve. Në veçanti, takimet fizike ofrojnë mundësinë për t'u takuar së afërmi me përfaqësuesit e QH; Shkëmbimi i këndvështrimeve dhe komenteve me ta është më i drejtpërdrejtë dhe kushtet në tërësi favorizojnë zhvillimin e dialogut reciprok dhe frytdhënës. Nga ana tjetër, kryerja e *workshop*-eve online ka potencialin për të 'mbledhur' një numër më të madh pjesëmarrësish dhe për të mundësuar diversitet dhe përfshirje më të gjerë gjeografike⁵. Gjetje të tilla konfirmojnë argumentet e shumë projekteve të zbatuara në kohën e COVID-it dhe post-COVID-it dhe vërtetojnë më tej se dixhitalizimi që pasoi periudhën pandemike pati efekte si negative, ashtu edhe pozitive në zbatimin e projekteve. Partnerët e WBC-RRI.NET angazhohen në vazhdimësi që t'i zbulojnë rast pas rasti këto mekanizma kontekstuale e shkasore, që sjellin efekte pozitive apo negative. Së fundmi, qofshin këto takime fizike apo online, temat e paraqitura duhet të jenë tërheqëse dhe brenda sferës së interesit të të ftuarve, duke u dhënë atyre një vlerë të shtuar për pjesëmarrjen e tyre.

Partnerët e WBC-RRI.NET rikonfirmojnë se aktorët akademikë dhe studiuesit kërkimorë nevojitet të inkurajohen për t'i ndarë kontributet e tyre. Duke pasur parasysh përvojën e tyre në fushën e kërkimit shkencor dhe njohuritë specifike mbi çështjet e ngritura, ata mund të ndajnë informacione të vlefshme për përfaqësuesit e tjerë të QH. Sa i përket pranisë së përfaqësuesve të ndryshëm të QH në të njëjtin takim ose event, përvoja e WBC-RRI.net provoi që mund të jetë sfidues angazhimi i të gjithëve njëkohësisht dhe arritja e një ndërveprimi efikas, duke pasur parasysh interesat e tyre të ndryshme. Megjithatë, takime të tilla kanë një potencial të jashtëzakonshëm për të nxitur bashkëpunimin e ardhshëm ndërmjet aktorëve dhe sektorëve të ndryshëm.

Përveç aktorëve akademikë, u përvetësuan njohuri specifike edhe për angazhimin e OSHC-ve. Ato mund të ndihmojnë në kapërcimin e disa vështirësive të komunikimit gjatë takimeve të bashkë-krijimit, pasi roli dhe aktivitetet e tyre kontribuojnë në tejkalimin e hendekut të komunikimit dhe të kuptuarit midis pjesës tjetër të përfaqësuesve të QH dhe komuniteteve rajonale/lokale. Konkluzione të ngjashme u arritën edhe në lidhje me angazhimin e përfaqësuesve të industrisë dhe biznesit; për të mundësuar një bashkëpunim të frytshëm me ta, nevojitet të ngrihet gradualisht bashkëpunimi, dhe të përshtaten kanalet e komunikimit, në mënyrë që të sheshohen hezitimet e rastit.

Së fundmi, kur aktorë qeveritarë marrin pjesë në *workshop*-e të tilla, prania e tyre mund të ketë një efekt të dyfishtë: a) siguron mbështetjen dhe zgjerimin e aktiviteteve të bashkë-projektimit në nivel kombëtar, por b) dekurajon dhe 'frikëson' komunitetet lokale, duke penguar herë pas here përfshirjen e tyre aktive. Kur kjo 'frikë' kombinohet më tej me hezitimin e shpeshtë të qytetarëve për të marrë pjesë në aktivitetet rajonale të inovacionit, kjo mund të çojë në identifikimin e qytetarëve si "hallka më e dobët e zinxhirit". Për të shmangur këtë, duhet ndryshuar qasja ndaj angazhimit e motivimit të tyre, bazuar në kontekstin specifik. Gjëja më e rëndësishme është që të gjithë aktorëve të QH t'u krijohen rrethanat e t'u jepet hapësira, koha e konteksti për të ndarë mendimet, idetë dhe përvojat e tyre.

Partnerët e WBC-RRI.NET kanë përdorur gjithashtu disa 'strategji', që i kanë ndihmuar në angazhimin e mëtejshëm të grupeve të interesit. Ato lidhen me evente që janë zhvilluar para aktiviteteve të bashkë-krijimit, për të vendosur kontekstin, si psh.: rritja e ndërgjegjësimit të pjesëmarrësve duke u ofruar informacion paraprak mbi projektin; organizimi i 'fokus grupeve' paraprake dhe takimeve informuese me aktorët rajonalë dhe pikat fokale të interesit në rajon, etj.

⁵ Për më shumë informacion shih Wu, J., Rajesh, A., Huang, Y.N., Chhugani et al (2022). Virtual meetings promise to eliminate geographical and administrative barriers and increase accessibility, diversity and inclusivity. *Nature Biotechnology*, 40(1), pp.133-137

Partnerët e WBC-RRI.NET raportuan se këto aktivitete u dhanë aktorëve të angazhuar ndjesinë e të paturit një rol më thelbësor në eventet rajonale, si një 'hap i parë' drejt ndërtimit të një marrëdhënieje besimi. Njëkohësisht, kjo ndjesi besimi mund të zbusë riskun që disa pjesëmarrës të ndihen të marginalizuar nga procesi i vendimmarrjes.

Gjatë realizimit të *workshop*-eve të bashkë-krijimit u përdorën disa teknika e metoda (online) që rezultuan shumë efikase në angazhimin interaktiv të përfaqësuesve të QH– për shembull, skenarët e së ardhmes rajonale⁶. Sigurimi i vijueshmërisë së komunikimit, si me të pranishmit ashtu edhe me aktorët që nuk mund të merrnin pjesë në *workshop*, duke i mbajtur ata të informuar për hapat e ardhshëm, u vlerësua gjithashtu si një qasje efektive për ruajtjen e interesit dhe angazhimin të aktorëve.

Në përgjithësi të gjithë partnerët arritën në përfundimin se është e rëndësishme që të lejohen hapësira fleksibiliteti dhe përshtatjeje ndaj planeve fillestare të aktiviteteve. Kjo bëhet akoma më e rëndësishme në eventet e bashkë-krijimit, ku pjesëmarrja dhe angazhimi i aktorëve nuk mund të parashikohen lehtësisht. Për shembull, disa partnerë të BP gjykuan të nevojshme të organizojnë *workshop*-e shtesë të bashkë-projektimit përtej dy *workshop*-eve të planifikuara. I njëjti fleksibilitet (ose edhe të paturit të një 'plani B') kërkohet edhe kur afati kohor për aktivitetet e planifikuara është disi 'i ngushtë' (p.sh. për shkak të kushteve të paracaktuara të grantit të financuar).

Sfidat e Hasura

Në kontekstin e bashkë-krijimit të proceseve rajonale të inovacionit është e rëndësishme të nënvizohen disa sfida të cilat mund ta pengojnë këtë proces. nënvizimi i sfidave që pengojnë procesin e bashkë-projektimit është mjaft me rëndësi. Sfida kryesore e hasur në rastin e bashkë-projektimit të WBC-RRI.NET i referohet angazhimit të aktorëve të QH në hartimin e iniciativave 'ankoruese' të RRI. Kapërcimi i hendekut të njohurive midis aktorëve të ndryshëm ishte sfidues, dhe veçanërisht trajtimi i hendekut që ekziston midis interesave të ndryshme të qytetarëve, përfaqësuesve të biznesit lokal, akademisë dhe përfaqësuesve qeverisës. Një sfidë tjetër i referohet paqëndrueshmërisë politike në nivel rajoni, që mund të pengojë zhvillimin dhe zbatimin e politikave rajonale të inovacionit, si dhe proceset e rëndësishme të bashkë-krijimit dhe vijueshmërisë së angazhimit të disa aktorëve.

Në këndvështrim të nxitjes së shkencës qytetare, sfida kryesore e hasur ishte vakumi gnostik dhe mungesa e të kuptuarit të shpjegimeve shkencore ose teknikaliteteve të kërkimit shkencor nga ana e disa aktorëve të QH. Kjo sfidë ngadalësoi angazhimin e tyre aktiv në *workshop*-et e bashkë-projektimit, duke sjellë reagime më të kufizuara nga sa synohej; ose kërkoi mobilizimin e përpjekjeve shtesë në takimet para *workshop*-eve, për të zbërthyer më në detaj konceptet e nevojshme shkencore që duheshin trajtuar gjatë bashkë-projektimit. Gjithashtu, herë pas here u shfaqën probleme besimi. Ndërsa disa nga temat e *workshop*-eve ishin të lidhura ngushtë me aktorë specifikë të QH-së, disa aktorë të tjerë shfaqeshin skeptikë në lidhje me temën, procesin, ose të dyja. Sa i përket shkakut të skepticizmit të aktorëve, disa partnerë kanë përmendur konfuzionin e aktorëve rajonalë ndaj konceptit të RRI, mungesën e besimit ndaj autoriteteve rajonale, si dhe supozimin se këto aktivitete publike përdoren vetëm si mjet për të legjitimuar elitat eksperte.

Sa i takon faktorëve logjistikë, organizimi i formatit *online* rezultoi si faktor lehtësues për të tërhequr më shumë pjesëmarrës, por gjithashtu shfaqti disa sfida për përfshirjen aktive të pjesëmarrësve. Siç përmendin partnerët e WBC-RRI.NET "...për shkak të formatit *online* të workshopit, disa nga pjesëmarrësit nuk ishin shumë të angazhuar", gjë që u vërtetua përmes fikjes së kamerave gjatë takimeve.

⁶ Territoret pjesëmarrëse në projekt kanë zhvilluar një sërë skenarësh të së ardhmes për rajonet, të cilat janë përmbledhur në një raport të dedikuar të projektit (D3.1).

Së fundmi, siç përmendet nga konsorciumi WBC-RRI.NET, korniza rigjide kohore për aktivitetet e planifikuara mund të dekurajojë disa prej aktorëve që t'i përkushtohen procesit. Strategjia zbutëse që sugjerohet nga partnerët WBC-RRI.NET është që t'i kushtohet gjithnjë shumë kujdes kufizimeve kohore të përcaktuara nga projektet Evropiane, duke u përpjekur paralelisht për arritjen e rezultateve më të mira të mundshme, duke punuar ngushtësisht me aktorët e QH për t'i mbajtur të interesuar dhe të angazhuar në procesin e bashkë-krijimit. Në këtë mënyrë ndërmerren hapa drejt qëndrueshmërisë së rezultateve të aktiviteteve rajonale dhe ndërtohet gradualisht vizioni i dëshiruar për secilin rajon.

IMPLIKIMET NË POLITIKBËRJE DHE REKOMANDIMET

Rëndësia për të gjithë aktorët e QH

- Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor nuk kanë ende ekosisteme të forta inovacioni dhe marrëdhëniet, si psh. ato midis akademisë dhe industrisë, kërkojnë përmirësime të mëtejshme, të udhëhequra nga bashkëpunimi, mësimi i ndërsjellë dhe situata të qarta *win-win*. Mundësitë e disponueshme duhet të përdoren për të ndërtuar besim dhe për të forcuar marrëdhëniet, si dhe për të rritur rrjetëzimin ndërmjet sektorëve të ndryshëm. Aktivitetet e bashkë-krijimit në projekte ndërtojnë kapacitete për ndërveprim produktiv dhe vetë-organizim.
- Aktivitetet e bashkë-krijimit, me teknikat e dhura të angazhimit, mund të kapitalizohen për krijimin e rrjetëzimit me ata aktorë që janë të gatshëm të ndryshojnë opinionet e (para)përcaktuara dhe të zhvillojnë mirëkuptim të ndërsjellë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në nivel rajonal në Ballkanin Perëndimor. Duhet të merret parasysh 'gjerësia' dhe 'thellësia' e synuar e rrjeteve që po krijohen, duke mbajtur të gjitha fazat e angazhimit transparente dhe të hapura.
- Përbërës kryesorë suksesi janë 'hapësirat e hapura' për diskutim midis palëve të interesuara të heliksit të katërfishtë, të cilat mundësojnë kohë dhe hapësirë për reflektim dhe shkëmbim, siç janë komunitetet e praktikave dhe grupet e punës me fokus specifik. Burimet, si koha dhe paratë, ashtu dhe njerëzit, duhet të shpërndahen në mënyrë adekuate. Procedurat dhe rezultatet përkatëse duhet të komunikohen hapur.
- Aktorët e QH duhet të mbështesin unanimisht profesionistë të përkushtuar në skenën e kërkimit dhe inovacionit, p.sh. lehtësuesit e aktiviteteve bashkë-projektuese dhe komunikuesit shkencorë, duke mbështetur institucionet dhe strukturat që janë ende të pazhvilluara në rajon.
- Aktualisht, ndërgjegjësimi dhe të kuptuarit e proceseve të bashkë-krijimit duhet ende të përmirësohet në të gjithë sektorët që trajtojnë RRI. Për shembull, WBC-RRI.NET konstatoi se ka ende mungesë ndërgjegjësimi për zbatimin e nismave të shkencës qytetare, mirëmbajtjen e të dhënave të hapura, zhvillimin e burimeve të hapura arsimore, qeverisjen e çështjeve etike, etj.

Aktorët qeveritarë

- Edhe pse ndonjëherë është më e lehtë që diskutimet e lidhura me RRI të fokusohen në nivel kombëtar, qeveritë vendore dhe rajonale luajnë role të rëndësishme për të shpalosur parimet në territor dhe për të siguruar qëndrueshmëri. Ato duhet të përfshihen në rrjetet e RRI dhe të frymëzohen për të zhvilluar interes dhe angazhim të plotë. Gjithashtu, organizatat ndër-qeveritare, si Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), janë institucione kyçe për mbështetjen e qasjes rajonale dhe identifikimin e prioritetëve përkatëse (p.sh., duke ndihmuar grupet e punës që lidhen me femrat në STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri e matematikë) ose shkencën e hapur).

- Palët e interesuara qeveritare duhet të përgatiten më mirë për përfshirjen në proceset pjesëmarrëse dhe për të menduar jashtë kornizave, duke reduktuar procedurat administrative dhe burokratike dhe duke inkurajuar zbatimin e parimeve të RRI, si p.sh. të promovojnë barazinë gjinore, diversitetin dhe gjithëpërfshirjen dhe pesëmarrjen në aktivitetet e të mësuarit të ndërsjelltë. Kornizat legjislative dhe rregullatore duhet të inkurajojnë zbatimin e praktikave të RRI, p.sh. aksesin dhe ripërdorimin e të dhënave dhe rezultateve shkencore, adresimin e dhunës me bazë gjinore, etj.
- Skemat e ndryshme të financimit dhe mbështetjes duhet të përfshijnë aspektet e RRI-së, të tilla si etikën, standardet e hapura ose barazinë gjinore, në proceset e vlerësimit, përzgjedhjes dhe monitorimit. Iniciativat që sjellin kërkimin dhe inovacionin më afër qytetarëve duhet të mbështeten më shumë (financiarisht). Aktorët joakademikë duhet të përfshihen sistematikisht në organet vendimmarrëse të ekosistemit të kërkimit dhe inovacionit.

Aktorët kërkimorë dhe akademikë

- RRI kërkon përfshirjen e përkushtuar të universiteteve, qendrave kërkimore, akademive të shkencave dhe shoqërive të arsimuara, rrjeteve të shkencëtarëve dhe gjithashtu studiuesve të pavarur, për të nxitur ndryshime në nivel institucional dhe individual.
- Kultura institucionale e organizatave që kryejnë kërkim duhet të ngrihet mbi parimet e RRI, p.sh. të përforcojnë integritetin akademik, etikën, gjithëpërfshirjen, pjesëmarrjen e rregullt në festivale shkencore, etj., dhe të inkurajojnë rrjetëzimin me të gjithë aktorët e QH. Stafi mbështetës duhet të jetë i disponueshëm, duke ofruar ndihmë praktike, p.sh. mbi angazhimin publik, shtrirjen, krijimin e burimeve të hapura, përfshirjen e aktorëve të marginalizuar dhe mbështetjen për të përmbushur kërkesat e aksesit të hapur ose etikës, etj.
- Gjithashtu, institucionet kërkimore dhe akademike duhet të lejojnë akses në infrastrukturën e tyre, duke ofruar udhëzime të qarta si mund të funksionojë kjo. Zhvillimi i shkencës dhe infrastrukturës me akses të hapur ka nevojë për një ndarje të qartë të roleve në lidhje me mirëmbajtjen e tyre dhe duhet të kapitalizojë mbi mundësitë e ofruara nga iniciativa të ndryshme të BE-së, si Konsorciumi i Infrastrukturës Kërkimore Evropiane (ERIC), Forumi Strategjik Evropian për Infrastrukturën Kërkimore (ESFRI), Reja e Shkencës së Hapur Evropiane (EOSC), etj.
- Skemat e zhvillimit profesional, trajnimeve dhe shkëmbimit të njohurive në lidhje me RRI janë të rëndësishme, kështu që çështjet e RRI dhe qasjet e bashkë-krijimit duhet të përfshihen në kurrikulat si dhe në skemat e edukimit të vazhdueshëm për stafin.

Aktorët e sektorit privat

- Të gjithë aktorët e sektorit privat duhet të përfshihen në proceset me pjesëmarrje, që nga industritë përkatëse dhe kompanitë private të të gjitha madhësive, d.m.th. organizatat e mëdha shumëkombëshe, deri te Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SME) dhe bizneset *start-up*. Menaxherët dhe punonjësit duhet të marrin pjesë në komitete, grupe pune ose tryeza të rrumbullakëta si pjesë e kulturës së shkëmbimit, si dhe për t'u lidhur me bashkëpunëtorë të "pazakontë".
- Dimensionet sociale të zhvillimit teknologjik dhe inovacionit duhet të konsiderohen sistematikisht brenda kontekstit socio-konstruktivist me qendërsi njerëzore të kërkimit dhe inovacionit. Veçanërisht, duhet të nxiten debatet rreth shqetësimeve të qytetarëve.
- Disa dimensione të RRI kanë nevojë për vëmendje të veçantë për sektorin privat, p.sh. sigurimi i barazisë gjinore në pozicionet drejtuese, duke mbështetur gratë në kërkim-zhvillim për biznese dhe promovimin e rrjeteve për sipërmarrëse femra. Gjithashtu duhet të përforcohen procedurat dhe praktikave të etikës në kërkimin dhe inovacionin e biznesit.

Aktorët e shoqërisë civile

- Organizatat e shoqërisë civile, si psh grupimet komunitare, sindikatat, bamirësitë private, fondacionet, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare joqeveritare dhe jofitimprurëse (OJQ-të dhe OJF-të) duhet të përpiqen të qëndrojnë të informuar përmes ekspertizës shkencore dhe gjithashtu të përdorin evidenca shkencore për të mbrojtur qëllimet e tyre. Rezultatet e aktiviteteve kërkimore dhe inovative duhet të jenë gjithashtu të arritshme për qytetarët dhe palët e interesuara të shoqërisë civile që kanë kapacitetin të shfrytëzojnë këtë njohuri.
- OSHC-të janë palë të rëndësishme interesi për sa i përket mobilizimit të komuniteteve të ndryshme dhe sigurimit të pjesëmarrjes në panele dhe debate publike. Për më tepër, komunikimi sistematik me ta dhe marrëdhëniet e besimit janë të rëndësishme për të shmangur keq-informimin dhe mos-informimin, si dhe për të kontrolluar faktet.
- OSHC-të duhet të marrin në konsideratë vendosjen e të dhënave të tyre në dispozicion të shkencëtarëve. Publikimet e tyre duhet të jenë të disponueshme në repozitorë të hapur dhe duhet të konsiderohet publikimi në revista, me bashkë-autorësi në artikuj shkencorë.

QËNDRUESHMËRIA DHE TRASHËGIMIA

Produktet e WBC-RRI.NET janë të disponueshme publikisht për t'u përdorur nga palët e interesuara. Për më tepër, pjesëmarrja në grupet e punës dhe aktivitetet e ankorimit është e hapur për palët e interesit nga rajonet dhe më gjerë. Veçanërisht tre grupet e punës të krijuara në projekt (GP1: Gjinia dhe Etika; GP2: Edukimi shkencor dhe Angazhimi Publik; GP3: Shkenca e Hapur dhe Akses i Hapur) lejojnë përfshirjen e shumë aktorëve të interesuar. Secili prej grupeve ndërmerr një sërë aktiviteteve sistematike të dedikuara për RRI, duke u mbështetur në qëllimet afatgjata, në trajektore dhe plane veprimi përkatëse, duke siguruar kështu përhapjen e aktiviteteve të RRI-së në rajon dhe qëndrueshmërinë e mëtejshme. Aktivitetet e planifikuara nga grupet e punës përfshijnë për shembull regjistrimin e *podcast*-eve, organizimin e *webinar*-eve dhe tryezave të rrumbullakëta që përfshijnë të gjithë aktorët e QH, etj. Fokusi është në krijimin e impaktit të qëndrueshëm në nivel rajonal në Ballkanin Perëndimor.

Nëpërmjet punës së vazhdueshme, një gamë e gjerë aktorësh po familjarizohen me konceptin e RRI dhe zbatimin e tij. Ndryshimet institucionale në organizatat pjesëmarrëse dhe efektet afatgjata të aktiviteteve të ankorimit do të vëzhgohen përtej kohëzgjatjes së projektit.

Gjithashtu faqja e internetit e projektit (<https://wbc-rii.net>) dhe platformat e mediave sociale të projektit përditësohen rregullisht dhe do të jenë aktive për të paktën tre vite pas përfundimit të projektit.

Për më tepër, konsorciumi dhe anëtarët e grupit të punës eksplorojnë mundësitë për projekte dhe iniciativa pasuese për të siguruar qëndrueshmërinë dhe trashëgiminë e projektit WBC-RRI.NET.

OBJEKTIVAT E PROJEKTIT DHE METODOLOGJIA

Megjithëse Ballkani Perëndimor është përmirësuar për sa i përket performancës së kërkimit dhe inovacionit, përpjekjet në sektor duhet të rriten më tej për të kapërcyer 'hendekun' me rajonet e tjera evropiane. Parimet e RRI mund të veprojnë si mundësues të zhvillimit të qëndrueshëm të sistemeve lokale të kërkim-inovacionit, duke rritur efektivitetin e strategjive të R&I dhe duke kontribuar në rritjen e progresit socio-ekonomik të Ballkanit Perëndimor në mënyrë transparente, të hapur dhe gjithëpërfshirëse, përmes pjesëmarrjes aktive të të gjithë aktorëve të Heliksit të Katërfishtë.

WBC-RRI.NET synon të nxisë zbatimin e parimeve të RRI në nivel territorial në pesë (5) ekosisteme të Ballkanit Perëndimor – katër në nivel rajoni dhe një në nivel vendi – dhe të promovojë një kornizë orientuese në shumë nivele qeverisëse të R&I. Parimet e RRI veprojnë si mundësues për mësimin e përbashkët dhe për përhapjen e inovacioneve qeverisëse të R&I në nivel territorial, duke rritur planifikimin e R&I dhe duke përfshirë Strategjitë S3 në rajon.

Objektivat specifike të projektit janë:

- Të rritet kapaciteti i sistemeve R&I lokale/rajonale për të trajtuar sfidat bashkëkohore shoqërore dhe prioritetet e kërkimit territorial,
- Të ndihmohen organizatat lokale të R&I të aneksojnë parimet e RRI për të adresuar në mënyrë efektive sfidat me të cilat përballen sot shkencëtarët dhe studiuesit,
- Të kontribuohet në përfundimin e Strategjive të Specializimit të Zgjuar në WB, duke promovuar një qasje më të hapur dhe gjithëpërfshirëse për zhvillimin e politikave të kërkimit dhe inovacionit,
- Të aplikohet një qasje politikbërëse me 'drejtimshmëri të zgjuar' në mënyrë që planifikimi i avancuar i inovacionit të 'përshtatet' ndaj sfidave shoqërore/rajonale,
- Të promovohet një kornizë orientuese në shumë nivele të qeverisjes së R&I në BP, duke avancuar konsultimin dhe planifikimin e politikave të inovacionit në nivel lokal dhe rajonal.

Projekti është konceptuar si evolucion përmes një filli analitik, reflektues dhe zbatues, dhe trajton në mënyrë operacionale pesë territoret e BP, duke ndikuar më tej në rajonin më të gjerë, nëpërmjet aktivizimit të përfshirjes së RRI në ekosistemet e tyre. Kjo po realizohet nga aktivitetet e RRI gjatë gjithë projektit, duke ngritur një dialog aktiv në rajonin më të gjerë të Ballkanit Perëndimor dhe duke nxitur të kuptuarit e të gjitha shtyllave të RRI-së nën një kornizë holistike, të bazuar në qasjen e 'drejtimshmërisë së zgjuar', duke ofruar angazhim të palëve të interesit me fokus pjesëmarrjen qytetare. Krahas kësaj, pesë iniciativa 'ankoruese' të RRI-së (aspekti vertikal), si ndërhyrje që prekin dimensionet specifike të RRI-së, veçoritë territoriale dhe dimensionet shkencore, lejojnë që parimet e RRI të rrënjosen në ekosistemet territoriale duke realizuar ndikim konkret në politikat territoriale të R&I dhe nevojat rajonale shoqërore. Partnerët e projektit përfaqësojnë gjithashtu të gjitha pjesët e heliksit të katërfishtë (QH). Së fundmi, vlerësimi i ndikimit dhe aktivitetet e shpërndarjes fokusohen në qëndrueshmërinë afatgjatë të projektit.

Kjo iniciativë rrit planifikimin e R&I, duke përfshirë strategjitë e specializimit të zgjuar në BP, dhe nxit një zhvillim të fortë socio-ekonomik, duke informuar politikbërjen e R&I dhe duke i mundësuar rajonit të adresojë më mirë nevojat e tij. Deri në finalizim të tij, projekti do të ketë ndezur dialogun e hapur, do të krijojë një rrjet rajonal dhe do të ndihmojë vendet e Ballkanit Perëndimor të kontribuojnë në qëllimin e krijimit të një Zone të vetme Kërkimore Evropiane pa kufij.

IDENTITETI I PROJEKTIT

EMRI I PROJEKTIT	Rrënjësja e RRI në vendet e Ballkanit Perëndimor: Përmirësimi i ekosistemeve të vetë-qendrueshme të Kërkim-Inovacionit (WBC-RRI.NET)
KOORDINATOR	Prof. Goran Stojanovic, Universiteti i Novi Sad-it, Novi Sad, Serbi, sgoran@uns.ac.rs
KONSORCIUMI	<ul style="list-style-type: none">- Shoqata "Dituria, Arsimi dhe Shkenca – ZONA" – Podgoricë, Mali i Zi- Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit – Tiranë, Shqipëri- Fondacioni Evropian i Shkencës – Strasburg, Francë- Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve – Shkup, Maqedonia e Veriut- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit – Tiranë, Shqipëri- NCDIEL – Shkup, Maqedonia e Veriut- Klasteri Shëndetësor RTD – Banja Luka, Bosnje dhe Hercegovinë- Parku Teknologjik Shkencor i Malit të Zi – Podgoricë, Mali i Zi- Qendra Kërkimore e Evropës Juglindore – Selanik, Greqi- Universiteti i Banja Lukës – Banja Luka, Bosnje dhe Hercegovinë- Universiteti i Novi Sadit – Novi Sad, Serbi- Klasteri ICT i Vojvodinës – Novi Sad, Serbi- Qendra për Inovacion Social – Vienë, Austri
SKEMA FINANCUERE	Horizont 2020: SwafS-14-2018-2019-2020: Supporting the development of territorial Responsible Research and Innovation
KOHËZGJATJA	Mars 2021 – Shkurt 2024 (36 muaj).
BUXHETI	Kontributi i BE-së: 1 999 995 €.
FAQJA	https://wbc-rri.net
PËR MË SHUMË INFORMACION	Koordinator: Goran Stojanovic (sgoran@uns.ac.rs) Autorët kryesorë: Maria Michali (mmichali@seerc.org) dhe Elke Dall (dall@zsi.at)
LEXIME TË MËTEJSHME	Ftesë për t'ju bashkuar grupeve të punës WBC-RRI.NET: https://wbc-rri.net/establishing-wbc-rri-net-working-groups-you-are-invited-to-join/ Ftesë për të ndarë praktikën e mira të RRI: https://wbc-rri.net/call-for-submission-of-good-practices-in-rri/